



Datë: 27.06.2026

DREJTORIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT

Në mbështetje të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, Statutit të Komunës së Fushë Kosovës Nr. 98, të datës 17.08.2012, Rregullores (MF) Nr. 04/2017 për Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve, si dhe Rregullores (K.FK) Nr. 83, të datës 14.06.2013, për Ndarjen e Subvencioneve, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport shpall këtë:

THIRRJE PUBLIKE

Për emërimin e anëtarëve të Komisionit për vlerësimin e projekt-propozimeve të OJQ-ve dhe individëve, të pranuar në kuadër të Thirrjes Publike me fushë prioritare: "Organizimi i turneve garuese në sporte të ndryshme në Komunën e Fushë-Kosovës", të Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

Njoftohen përfaqësuesit e OJQ-ve dhe të shoqërisë civile që veprojnë në Komunën e Fushë-Kosovës, të cilët kanë aplikuar sipas thirrjes publike të datës **24.06.2026, Nr.1048** se mund t'i dërgojnë propozimet e tyre për të përzgjedhur anëtarët e Komisionit Vlerësues i cili do të themelohet për të vlerësuar aplikacionet për financimin e OJQ-ve për projekt-programet që kontribuojnë në avancimin dhe afirmimin e kulturës, rinisë dhe sportit.

Ky komision **do të plotësohet me** dy përfaqësues nga grupi i ekspertëve të jashtëm të cilët nuk janë nën hetime apo me procedurë penale dhe që kanë përvojë në shoqëri civile me përparësi nga OJQ-të që merren me fushën e Kulturës, Rinisë dhe Sportit:

- Një përfaqësues nga OJQ-të, dhe
- Një përfaqësues në cilësinë e ekspertit.

Të drejtë aplikimi kanë:

- Të angazhuarit në Organizatat Joqeveritare aktive që veprojnë në Komunën e Fushë Kosovës;
- Ekspertë të pavarur të cilët kanë përvojë pune që ndërlidhet me hartimin dhe menaxhimin e projekteve në fushën e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.



Kandidatët duhet të plotësojnë këto kushte:

- Duhet të kenë diplomë universitare.
- Të kenë përvojë në hartimin dhe menaxhimin e projekteve të OJQ-ve në Kulturë, Rini dhe Sport.
- Të mos jenë të emëruar politik, shërbyes civil apo pozita të ngjashme në administratën shtetërore.

Kandidatët duhet të dorëzojnë këto dokumente:

- Një CV.
- Përfaqësuesi nga OJQ-të duhet të dorëzojë një letër nominimi nga udhëheqësi i OJQ-së në të cilën dëshmohet se aplikuesi është i punësuar apo angazhuar në Organizatë.
- Përfaqësuesi në cilësinë e ekspertit duhet të ketë diplomë universitare në fushën e arteve, kulturës apo sportit.

Dokumentet e kompletuara duhet t'i dorëzoni në Zyrën Pritëse në ndërtesën e Komunës së Fushë-Kosovës nga data :27.06.2026 deri me datë: 01.07.2026.

**Nr. 33/2026
Fushë-Kosovë**

- Arkivit
- Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport

Drejtore i DKRS

Ylber Kelmendi

